



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:105647
Datë: 30.01.2024
Numri i dokumentit: 05258656

C.nr.672/2021

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Leart Rexhaj, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Sejdiu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.H nga M; N.G nga V; S.M nga V; S.V nga M dhe S. R nga M, të cilët i përfaqëson av.U.G nga M., kundër të paditurës K.M-DKA, baza e kontestit: Kompensim i pagave shtesë në emër të licencimit, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqës në procedurën e Ndërmjetësimit, jashtë seance, me datë 23.01.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET MARRËVESHJA, për zgjidhje të ndërmjetësuar, me numër të lëndës Nd.Nr.512/2023, e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Mitrovicë me datë 11.01.2024, në mes të paditësve N.H nga M; N.G nga V; S.M nga V; S.V nga M dhe S.R nga M, të cilët i përfaqëson av.U.G nga M., kundër të paditurës K.M-DKA, baza e kontestit: Kompensim i pagave shtesë në emër të licencimit dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbaues.

A r s y e t i m

Paditësit përmes te autorizuarit të tij pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë kanë parashtruar padi me datë 31.05.2021, kundër të paditurës K.M-DKA, baza juridike: Kompensim i pagave shtesë në emër të licencimit.

Ndërmjetësuesi Bekim Ismajli me parashtrësën e datës 11.01.2024, e ka njoftuar gjykatën se palët ndërgjyqëse, kanë arritur marrëveshje për këtë çështje kontestimore, duke ia dorëzuar gjykatës marrëveshjen e lidhur në mes tyre.

Gjykata duke ju referuar të cekurave më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 3.3, 411 dhe 412 të LPK, e lidhur me nenin 3, 4, 10 dhe 15.1 Ligjit për Ndërmjetësim me nr.06/L-009, i cili ka hyrë në fuqi me dt.28.07.2018, ka ardhur në përfundim se marrëveshja e arritur në procedurë të ndërmjetësimit duhet të aprovohet, pasi plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe e njëjta është dokument përmbarimor, pra paraqet titull përmbarues.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.672/2021 me dt.23.01.2024

Gj y q t a r i
Leart Rexhaj

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.